**VENDIM**
**Nr.688, datë 18.8.2010**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në shkronjën "b" shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Përjashtohen nga ky rregull Ministria e Brendshme, njësitë shpenzuese në përbërje të programit buxhetor "Policia e Shtetit", njësia shpenzuese e Gardës së Republikës dhe Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm.".

2. Në fund të shkronjës "dh" bëhet kjo shtesë:

"Përjashtim bëjnë:

a) Njësitë e qeverisjes vendore;

b) Njësitë e fondeve speciale;

c) Ministria e Financave, e cila lejohet të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme:

i) Shtesë kontrate në vazhdim të kontratës fillestare me shoqërinë "Oracle", me objekt "Transferim të njohurive dhe suport për sistemin AMoFTS".

ii) Shtesë kontrate në vazhdim të kontratës fillestare me subjektin White&Case, me objekt "Konsulencë për emetimin e Eurobond-it".

iii) Riparim dhe shërbim makinash 2010.

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila lejohet të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme, me objekt:

i) "Blerje pjesësh këmbimi për automjete".

ii) "Mirëmbajtje e mjeteve të transportit".

d) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila lejohet të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme me objekt:

i) "Shërbim i automjeteve, për vitin 2010, për DPT-në".

ii) "Hartim i projektzbatimit dhe preventivit përfundimtar për mjediset e shërbimit të tatimpaguesve dhe ngritje kati në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Korçë, shërbimi i tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale, Shkodër dhe Elbasan, shtesë e mjediseve në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Sarandë".

dh) Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe disa institucione të varësisë, të cilat lejohen të vijojnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve, për studime e projektime të objekteve të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja, për projektim objekti e shërbime, të përcaktuara në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

e) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila lejohet të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve të mëposhtme, me objekt:

i) "Hartimi i projektzbatimit për rikonstruksionin e dhomave të serverave, për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", me fond limit 1 620 000 (një milion e gjashtëqind e njëzet mijë) lekë.

ii) "Shtrimi me fibër optik për zgjerimin e rrjetit kompjuterik ndërministror GovNet, në

Tiranë, si dhe ndërtimi i tij në Durrës dhe Elbasan", me fond limit 48 234 562 (dyzet e tetë milionë e dyqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.

iii) "Realizimi i kurseve profesionale për specialistët e fushës së teknologjisë dhe informacionit" për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe ministritë/institucionet e varësisë, me fond limit 9 735 120 (nëntë milionë e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet) lekë.

iv) "Rritja e sigurisë dhe shërbimeve në rrjetin GovNet", për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me fond limit 75 201 600 (shtatëdhjetë e pesë milionë e dyqind e një mijë e gjashtëqind) lekë.

v) "Realizimi i rikonstruksionit të dhomave të serverave, për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", me fond limit 46 000 000 (dyzet e gjashtë milionë) lekë.".

3. Në shkronjën "ë" shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Për njësitë shpenzuese, në përbërje të programit buxhetor "Policia e Shtetit", njësinë shpenzuese të Gardës së Republikës dhe Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, miratimi bëhet, përkatësisht, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Komandanti i Gardës së Republikës dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHKB-së.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

TABELA E PROKURIMEVE

| Nr. | Objekti i prokurimit | Fondi limit në lekë | Emri i institucionit |
|---|---|---|---|
| 1 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Berat | 1 500 000 | Bordi i kullimit Berat |
| 2 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Durrës | 1 500 000 | Bordi i kullimit Durrës |
| 3 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Elbasan | 1 500 000 | Bordi i kullimit Elbasan |
| 4 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Fier | 4 200 000 | Bordi i kullimit Fier |
| 5 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Korçë | 8 000 000 | Bordi i kullimit Korçë |
| 6 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Kukës | 3 000 000 | Bordi i kullimit Kukës |
| 7 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Lezhë | 8 000 000 | Bordi i kullimit Lezhë |
| 8 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Lushnjë | 3 000 000 | Bordi i kullimit Lushnjë |
| 9 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Mat | 2 000 000 | Bordi i kullimit Mat |
| 10 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Kavajë | 4 000 000 | Bordi i kullimit Tiranë |
| 11 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Vlorë | 2 000 000 | Bordi i kullimit Vlorë |
| 12 | Studim, projektim të objekteve për vitet 2010-2011, Sarandë | 2 000 000 | Bordi i kullimit Vlorë |
| 13 | Studim, projektim, preventivin zyra për AZHBR | 3 000 000 | AZHBR Tiranë |
| 14 | Blerje reagenti dhe kimikate | 4 800 000 | ISUV Tiranë |
| 15 | Blerje kite diagnostikuese dhe antigene | 6 800 000 | ISUV Tiranë |
| 16 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 361 654 | Aparati i MBUMK |
| 17 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 2 587 139 | DRBUMK Berat |
| 18 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 3 421 200 | DRBUMK Durrës |
| 19 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 980 392 | DRBUMK Elbasan |
| 20 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 575 600 | DRBUMK Kukës |
| 21 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 839 585 | DRBUMK Shkodër |
| 22 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 2 033 416 | DRBUMK Tiranë |
| 23 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 871 459 | DRBUMK Vlorë |
| 24 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 215 000 | Bordi i kullimit Berat |
| 25 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 815 540 | Bordi i kullimit Durrës |
| 26 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 271 000 | Bordi i kullimit Elbasan |
| 27 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 2 178 648 | Bordi i kullimit Fier |
| 28 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 452 000 | Bordi i kullimit Gjirokastër |
| 29 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 632 000 | Bordi i kullimit Korçë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 30 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 900 000 | Bordi i kullimit Lezhë |
| 31 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 7 262 400 | Bordi i kullimit Lushnjë |
| 32 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 980 392 | Bordi i kullimit Mat |
| 33 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 869 600 | Bordi i kullimit Shkodër |
| 34 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 3 190 740 | Bordi i kullimit Tiranë |
| 35 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 047 600 | Bordi i kullimit Vlorë |
| 36 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 3 631 200 | ISUV Tiranë |
| 37 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 089 600 | Enti i Farërave Tiranë |
| 38 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 1 016 700 | AKDC |
| 39 | Shërbimi i ruajtjes me rojë private | 4 085 965 | AKU |

Shënim. Për shërbimin e ruajtjes me rojë private të vazhdojnë procedurat e prokurimit për periudhën e mbetur brenda fondeve limite fillestare, të përcaktuara si më sipër.